

# **S T A T U T**

## **I SHOQATËS KOMBËTARE TË GJYQTAREVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë, është një organizatë jofitimprurëse, e krijuar në zbatim të ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001, “Për organizatat jofitimprurëse”, si dhe ligjit nr. 8789, datë 07.05.2001, “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”.

### **KREU I**

#### **Dispozita të përgjithshme**

##### **Neni 1**

##### **Forma e Organizimit**

Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë është një bashkim vullnetar profesional i gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë, e krijuar mbi vullnetin e lirë të anëtarëve të saj, duke përfshirë të gjitha nivelet e gjyqësorit që pranojnë statutin e saj si një organizatë jofitimprurëse.

##### **Neni 2**

##### **Emri, sigla dhe simboli**

Emri i shoqatës është “Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë”, me inicialet “SH.K.GJ.R.SH.”.

Shoqata ka siglën dhe simbolin e saj, të cilat do të shoqërojnë të gjithë dokumentacionin dhe publikimet e saj.

##### **Neni 3**

##### **Qëllimi dhe veprimtaria**

Shoqata ka këto qëllime dhe kryen këto veprimtari:

- Konsolidimin, forcimin dhe mbrojtjen e pavarësisë së gjyqtarëve dhe të sistemit gjyqësor në tërësi;
- Promovimin dhe inspirimin e vlerave të gjyqtarëve, në veçanti, dhe të sistemit gjyqësor në përgjithësi në Republikën e Shqipërisë, zhvillimin e profesionalizmit në gjyqësor, rritjen e besueshmërisë së publikut tek gjyqësori dhe institucionet ndërkombëtare, zhvillimin dhe implementimin e statusit të gjyqtarëve në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me standardet ndërkombëtare në këtë fushë;
- Përmirësimin dhe zgjerimin e një rrjeti komunikimi midis gjyqtarëve, për të promovuar vlerat më pozitive brenda sistemit si dhe bashkëveprimin e këtij organizmi me organizmat ndërkombëtarë analoge, në shkëmbimin e eksperiencave midis tyre;
- Rritjen e rolit të gjyqtarëve në ushtrimin e funksionit të tyre kushtetues në dhënien e drejtësisë jashtë çdo lloj ndikimi;
- Krijimi i një instrumenti të posaçëm për bashkimin dhe përvijimin e mendimeve tekniko – juridike të gjyqtarëve për të gjitha aspektet e zhvillimit të sistemit të drejtësisë dhe të korpusit juridik në Republikën e Shqipërisë, reformimin e vazhdueshëm të

- sistemit të drejtësisë si një mjet i zhvillimit dinamik të jurisprudencës, në përputhje me të gjitha standardet ndërkombëtarisht të pranuar;
- Angazhimin për përmirësimin e kushteve të punës, ekonomike dhe të sigurisë fizike të gjyqtarëve si dhe të familjeve të tyre;
  - Nxitjen dhe organizimin e seminareve, takimeve të ndryshme, me qëllim rritjen e nivelit profesional dhe performancës së gjyqtarëve;
  - Organizimin dhe stimulimin e aktiviteteve profesionale të gjyqtarëve në të gjitha gjykatat si dhe aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare në këtë fushë;
  - Mbështetjen dhe promovimin e gjyqtarëve të talentuar, duke bërë rekomandime para organeve kompetente kushtetuese;
  - Shkëmbimin e eksperiencave kombëtare, rajonale, evropiane dhe më gjerë;
  - Angazhimin dhe pjesëmarrjen në dhënien e mendimeve juridike, në lidhje me projektligjet që kanë të bëjnë me reformimin e sistemit gjyqësor;
  - Mbrojtjen e sistemit gjyqësor në tërësi, duke ndërmarrë iniciativa për goditjen e ligjeve antikushtetuese, që kanë të bëjnë me këtë sistem apo statusin e gjyqtarëve, në Gjykatën Kushtetuese;
  - Nxitjen dhe stimulimin e mendimeve juridiko – profesionale të gjyqtarëve; nëpërmjet mundësisë së botimit të një reviste;

#### **Neni 4**

#### **Selia dhe territori i veprimtarisë**

Shoqata e ka selinë e saj qendrore në Tiranë dhe e shtrin veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

#### **Neni 5**

#### **Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqatës është e pa kufizuar.

### **KREU II**

#### **Organet e Shoqatës**

#### **Neni 6**

Organet e Shoqatës janë:

- Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve;
- Këshilli Drejtues;
- Kryetari;
- Nënkyetari;
- Sekretari;

#### **Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve**

#### **Neni 7**

Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve është mbledhja e të gjithë anëtarëve të Shoqatës dhe përbën organin më të lartë vendimmarrës të saj. Ajo mbledhet të paktën një herë në vit.

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtareve drejtohet nga Kryetari i Shoqatës dhe në mungesë të tij nga nënkryetari, sipas rendit të ditës të miratuar me parë nga Këshilli Drejtues.

Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve thirret në mbledhjen e saj vjetore nga Kryetari i Shoqatës, Nënkryetari, Këshilli Drejtues ose 1/5 (një e pesta) e anëtarëve, me një rend dite të njoftuar më parë nga subjekti që ka thirrur mbledhjen.

Pjesëmarrja në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme bëhet me prezencë fizike ose nëpërmjet platformave elektronike (online).

### **Neni 8**

Asambleja e Përgjithshme e Anëtareve ka këto kompetenca:

- Vendos për ndryshimin e statutit, me shumicën absolute të anëtarëve të saj;
- Nxjerr norma për rregullimin e veprimtarisë, organizimit dhe strukturës së Shoqatës, nëpërmjet miratimit të një rregulloreje të brendshme, me shumicën absolute të anëtarëve të saj;
- Përcakton fushat dhe programet e veprimtarisë së Shoqatës;
- Mbikëqyr dhe kontrollon rregullisht realizimin e programeve dhe veprimtarisë së Shoqatës dhe drejtimin e punës së saj;
- Zgjedh Këshillin Drejtues të Shoqatës, Kryetarin dhe Nënkryetarin;
- Krijon komitete të posaçme për realizimin e veprimtarisë së Shoqatës;
- Miraton raportin vjetor të punës së Shoqatës;
- Shqyrton dhe miraton buxhetin për vitin e ardhshëm;
- Vendos për bashkimin, ndarjen ose shpërndarjen e Shoqatës;
- Miraton kërkesat për pranimin e anëtarëve të rinj;
- Vendos për çështje të tjera të parashikuara shprehimisht në ligj ose në statut.

### **Neni 9**

Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve merr vendime me votim të hapur, me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe.

Mbledhja e asamblesë është e vlefshme kur në të marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të saj. Vendimet merren me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje, me përjashtim të rastit kur në këtë statut përcaktohet një shumicë e cilësuar.

### **Këshilli Drejtues**

#### **Neni 10**

Këshilli Drejtues është organi drejtues i Shoqatës, i cili zgjidhet nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtareve.

Këshilli Drejtues përbëhet nga 9 (nëntë) anëtarë, me një mandat 2 (dy) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje të njëpasnjëshme vetëm një herë. Anëtar i Këshillit Drejtues mund të zgjidhet çdo anëtar i Shoqatës, në bazë të kërkesës me shkrim të vetë subjektit ose çdo anëtar tjetër .

Në përbërje të Këshillit Drejtues nuk mund të jenë me shume se 2 (dy) prej anëtareve të tij me funksion kryetar gjyqate ose anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, më shumë se 1 (një) anëtar, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Lartë dhe më shumë se 3 (tre) anëtarë, me funksion gjyqtar në gjykatat e apelit.

Këshilli Drejtues drejtohet nga Kryetari i Shoqatës, i cili është në të njëjtën kohë edhe kryetar i Këshillit Drejtues dhe në mungesë të tij nga Nënkryetari.

Këshilli Drejtues mbledhet me kërkesën e Kryetarit të Shoqatës, Nënkryetarit ose 1/3 (një të tretës) së anëtarëve të tij, jo me pak se 4 (katër) herë në vit, me një rend dite të njoftuar më parë nga subjekti që ka thirrur mbledhjen.

Pjesëmarrja në mbledhjen e Këshillit Drejtues bëhet me prezencë fizike ose nëpërmjet platformave elektronike (online).

Këshilli Drejtues i zhvillon mbledhjet kur janë të pranishëm jo me pak se 2/3 (dy të tretat) e anëtarëve të tij dhe i merr vendimet me shumicën e anëtarëve të tij.

Anëtari i Këshillit Drejtues shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve me shumicën absolute të votave.

Propozimi për shkarkimin e anëtarit të Këshillit Drejtues bëhet me shkrim dhe mund të iniciohet nga Kryetari, 1/5 (një të pesta) e anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme ose nga Këshilli Drejtues.

## **Neni 11**

Këshilli Drejtues i Shoqatës ka këto kompetenca:

- Përgatit projekt – programin vjetor të aktiviteteve dhe ia paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve;
- Përgatit raportin vjetor të realizimit të detyrave të Shoqatës dhe ia paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve;
- Cakton masën e kuotës për anëtarët e Shoqatës dhe mënyrën e mbledhjes së saj;
- Krijon departamente të veçanta, në funksion të realizimit të qëllimeve të Shoqatës;
- Koordinon dhe vendos për propozimet që bëhen nga organe dhe organizata të ndryshme, me qëllim bashkëpunimi e ndihme të ndërsjelltë;
- Merr në konsideratë çdo shqetësim të rëndësishëm e të ligjshëm nga anëtarët e Shoqatës dhe merr vendim në lidhje me të;
- Kujdeset për interesat e anëtarëve të Shoqatës dhe platformës së saj te veprimi;
- Harton dhe paraqet raporte lidhur me legjislacionin, në përputhje me qëllimet e Shoqatës;
- Emëron Sekretarin e Shoqatës;
- Ka çdo kompetencë tjetër që në statut nuk është parashikuar se i përket organeve të tjera të Shoqatës.

## **Kryetari i Shoqatës**

### **Neni 12**

Një nga anëtarët e Këshillit Drejtues zgjidhet Kryetar i Shoqatës. Kryetari i Shoqatës ka një mandat 2 (dy) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje të njëpasnjëshme vetëm një herë.

Propozimi për kandidim, për Kryetar Shoqate, bëhet me shkrim, nga jo më pak se 1/5 (një e pesta) e anëtarëve të Shoqatës. Çdo anëtar i Shoqatës nuk mund të propozojë më tepër se një emër për kandidim.

Nëse në votimin e parë asnjë prej kandidatëve nuk merr shumicën e kërkuar, votimi përsëritet ndërmjet dy kandidatëve që kanë marrë numrin më të madh të votave, në votimin e parë. Kur ka dy ose më shumë kandidatë, në vendin e dytë, që janë me vota të barabarta, përzgjedhja bëhet me short për kandidatin që do të vazhdojë garën.

Detyra e Kryetarit të Shoqatës është e papajtueshme me funksionin e anëtarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe me funksionin e kryetarit të Gjykatës.

Kryetari i Shoqatës shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve me shumicën absolute të votave, kur ai nuk përmbush detyrat e përcaktuara në statut.

Propozimi për shkarkimin e Kryetarit bëhet me shkrim dhe mund të iniciohet nga Këshilli Drejtues ose 1/5 (një e pesta) e anëtareve të Shoqatës.

### **Neni 13**

Kryetari i Shoqatës ka këto kompetenca:

- Përfaqëson Shoqatën në marrëdhënie me të tretët;
- I propozon Këshillit Drejtues emërimin e Sekretarit të Shoqatës;
- Thërret mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve dhe e drejton atë;
- Thërret mbledhjen e Këshillit Drejtues dhe e drejton atë;
- Drejton veprimtarinë e Shoqatës në bazë të Statutit;
- Administron fondet sipas mënyrës së caktuar nga Këshilli Drejtues;
- Mban raportin vjetor para Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve.

### **Nënkryetari i Shoqatës**

#### **Neni 14**

Një nga anëtarët e Këshillit Drejtues zgjidhet Nënkryetar i Shoqatës. Nënkryetari i Shoqatës ka një mandat 2 (dy) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje të njëpasnjëshme vetëm një herë.

Propozimi për kandidim, për Nënkryetar Shoqate, bëhet me shkrim, nga jo më pak se 1/5 (një e pesta) e anëtarëve të Shoqatës. Çdo anëtar i Shoqatës nuk mund të propozojë më tepër se një emër për kandidim.

Nëse në votimin e parë asnjë prej kandidatëve nuk merr shumicën e kërkuar, votimi përsëritet ndërmjet dy kandidatëve që kanë marrë numrin më të madh të votave, në votimin e parë. Kur ka dy ose më shumë kandidatë, në vendin e dytë, që janë me vota të barabarta, përzgjedhja bëhet me short për kandidatin që do të vazhdojë garën.

Nënkryetari i Shoqatës shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve me shumicën absolute të votave, kur ai nuk përmbush detyrat e përcaktuara në statut.

Propozimi për shkarkimin e Nënkryetarit bëhet me shkrim dhe mund të iniciohet nga Kryetari i Shoqatës, Këshilli Drejtues ose 1/5 (një e pesta) e anëtareve të Shoqatës.

#### **Neni 15**

Nënkryetari i Shoqatës kryen funksionet e Kryetarit kur ky i fundit ka papajtueshmëri për ta kryer detyrën e tij si dhe në rast mungese të këtij të fundit ose delegimi. Gjithashtu Nënkryetari i Shoqatës kryen çdo funksion tjetër që parashikohet në këtë Statut ose që i ngarkohet nga Këshilli Drejtues.

### **Sekretari i Shoqatës**

#### **Neni 16**

Sekretari i Shoqatës zgjidhet nga Këshilli Drejtues, pas propozimit të bërë nga Kryetari.

Sekretari i Shoqatës mban procesverbalet e mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve, të Këshillit Drejtues si dhe administron të gjithë dokumentacionin e Shoqatës. Sekretari i Shoqatës kryen edhe çdo funksion tjetër që i ngarkohet nga Këshilli Drejtues.

Sekretari i Shoqatës shkarkohet nga Këshilli Drejtues me propozim të Kryetarit, Nënkyetarit ose 1/3 (një të tretës) së anëtarëve të Këshillit Drejtues kur nuk kryen detyrat e tij funksionale ose kur shkel këtë Statut.

### **KREU III**

#### **Anëtarësia e Shoqatës**

##### **Neni 17**

Anëtar i Shoqatës mund të jete çdo gjyqtar i çdo gjykate në territorin e Republikës së Shqipërisë. Anëtar i Shoqatës nuk mund të bëjë propagandë kundër qëllimit të kësaj Shoqate, të përcaktuar në Aktin e Themelimit dhe në këtë Statut.

##### **Neni 18**

Pranimi i anëtarëve të rinj bëhet kundërt një kërkesë me shkrim, në të cilën duhet të thuhet shprehimisht se nuk ka asnjë nga pengesat e parashikuara në Statut.

Kërkesa e anëtarit të ri i paraqitet Kryetarit dhe miratohet në mbledhjen e ardhshme të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve.

##### **Neni 19**

#### **Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të Shoqatës**

Çdo anëtar i Shoqatës ka këto të drejta dhe detyra:

- Të zgjedhë dhe të zgjidhet në organet drejtuese të Shoqatës, përveç rasteve kur ekziston një prej ndalimeve të përcaktuara në këtë Statut;
- Të marrë pjesë në mënyrë aktive në të gjitha aktivitetet e Shoqatës;
- Të marrë pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve të Shoqatës;
- Te kontribuojë në Shoqatë me studime, punime e të dhëna të tjera të çdo lloji, që përputhen me qëllimin e Shoqatës;
- Të zbatojë Statutin dhe të paguajë kuotizacionin në vlerën që do të përcaktojë Këshilli Drejtues;

##### **Neni 20**

#### **Mbarimi i anëtarësisë**

Anëtarësia e Shoqatës mbaron me dorëheqje, me përjashtim, me mbarimin e funksionit të anëtarit si gjyqtar ose me vdekjen e tij.

##### **Neni 21**

#### **Përjashtimi i anëtarit të Shoqatës**

Përjashtimi i anëtarëve nga Shoqata bëhet vetëm individualisht, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve, kur shkel Statutin e Shoqatës ose kur kryen veprimtari në kundërshtim me interesat e kësaj Shoqate. Propozimi për përjashtimin e tij bëhet me shkrim dhe mund të iniciohet nga Kryetari i Shoqatës, Këshilli Drejtues ose 1/10 (një e dhjeta) e anëtarëve të Shoqatës.

### **KREU IV**

#### **Dispozita të fundit**

## **Neni 22**

### **Burimet financiare**

Burimet financiare të shoqatës përbehen nga kuotizacionet e vetë anëtarëve të shoqatës dhe nga financimet e donatoreve të ndryshëm, të cilat pranohen me vendim të Këshillit Drejtues, në përputhje me ligjin.

Ndalohet shpërndarja e fitimeve midis anëtarëve të Shoqatës. Çdo veprimtari ekonomike ose jo ekonomike e shoqatës, kur ka të tilla, duhet të përdoret vetëm për realizimin e qëllimeve të përcaktuara në Statutin e saj.

## **Neni 23**

Këshilli Drejtues zgjedh një komision auditi, i cili i raporton Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve çdo fund viti.

Komisioni është i detyruar t'i raportojë edhe Këshillit Drejtues sa here që një gjë e tillë i kërkohet prej tij.

## **Neni 24**

### **Shpërndarja e Shoqatës**

Shpërndarja e Shoqatës bëhet kur:

- Numri i anëtarëve të saj bie nën 50% (pesëdhjetë për qind) të numrit të anëtarëve themelues të Shoqatës;
  - Kur vërtetohet se Shoqata ka ushtruar veprimtari të kundërligjshme;
  - Kur e kërkojnë më shumë se gjysma e anëtarësisë së Shoqatës;
  - Në raste të tjera sipas këtij statuti ose në rastet e parashikuara në ligj;
- Në rast shpërndarje të shoqatës ajo ç'regjistrohet dhe pushon veprimtarinë e saj.

## **Neni 25**

Çdo gjë që nuk është parashikuar në Statut rregullohet sipas ligjit. Ky Statut hyn në fuqi ditën e regjistrimit të Shoqatës si person juridik në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.